



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:071385
Datë: 29.02.2024
Numri i dokumentit: 05395123

C.nr.198/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtare Njomëza Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale D.A. në çështjen juridike kontestimore të paditëses BKS me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson B.H. nga Kompania V.A.R.S. kompleksi Dardania, kundër të paditurit D.K. nga fsh. Komuna e Prizrenit, për shkak të rimbursimit të dëmit, vlera e kontestit 2,524.00€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, më datë 27.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses B.K.S. me seli në Prishtinë, **në tërësi si e bazuar.**
- II. DETYROHET** i padituri D.K. nga fsh. Komuna e Prizrenit, që në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit, të datës 11.10.2017 në Prizren, t'i paguaj paditëses shumën **prej 2,524.00€ (dymijë e pesëqind e njëzetë e katër euro)**, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë (datë 18.06.2020), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- III. OBLIGOHET** i padituri që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 190.00€ (njëqind e nëntëdhjetë euro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja B.K.S. me seli në Prishtinë, më datë 18.06.2020, në Gjykatën Themelore në Prizren, ka paraqitur padi kundër të paditurit D.K. nga fsh. Komuna e Prizrenit, për shkak të rimbursimit të dëmit, duke theksuar se i padituri me datë 11.10.2017 rreth orës 10:18 minuta në Prizren, ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin "Ssangiong Rexton", me targa të regjistrimit dhe deri tek aksidenti ka ardhur kur automjeti "A" të cilin e drejtonte Driton Kabashi i cili nga pakujdesia i shkaktonte dëme të dëmtuarve familja B. Gjithashtu ka theksuar se automjeti i cili ka qenë shkaktar i aksidentit në fjalë në momentin e shkakimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë siguruese, konkretisht me afat të skaduar të policës siguruese. E dëmtuara nga ky aksident A.B. ka paraqitur padi C.nr.171/18 për kompensimin e dëmit ndaj të paditurës BKS, për të cilën padi me datë 21.09.2018 është lidhur pajtim jashtëgjyqësor, me qëllim të kompensimit të dëmit për të dëmtuarën në shumë prej 1,555.00€ e cila është paguar me datë

25.09.2018. Ndërsa me datë 23.02.2018 për padinë C.nr.1976/17 është lidhur pajtim jashtëgjyqësor, me qëllim të zhdëmtimit për familjen B. (S dhe S.) në shumë prej 1,369.00€. Si rezultat i këtij aksidenti paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit në respektim të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Nr.04L-018 dhe në respektim të dispozitave të LMD-së, ka kërkuar nga gjykata që padia dhe kërkesëpadija e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

I autorizuari i paditëses edhe për gjatë seancave gjyqësore dhe fjalës përfundimtare ka ngelur pranë padisë dhe kërkesëpadiisë pasi që sipas raportit policor 2017-GR-0836 të datës 11.10.2017 i padituri ka shkaktuar aksident trafiku me dëme materiale dhe jo materiale të dëmtuarve S.B., S.B. dhe A.B. duke shtuar se pas administrimit të provave u vërtetua baza juridike dhe lartësia e paditësit për kërkesëpadinë andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë në tërësi si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e saj, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%. Shpenzimet të procedurës i ka kërkuar dhe atë në emër të taksës gjyqësore shumë prej 40.00 € si dhe shpenzimet e ekspertizës në lartësi prej 150.00 €.

Gjykata me datë 07.09.2022 ka marr aktvendim C.nr.198/20, për përgjigje në padi përmes të cilit e ka detyruar të paditurin për përgjigje në padi. Këtij aktvendimi ia ka bashkangjitur padinë dhe provat e padisë, dhe sipas provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës (fletë kthesa), del se e njëjta është pranuar nga i padituri me datë 13.09.2022, mirëpo i njëjti nuk ka dhënë përgjigje në padinë e paditëses. Në anën tjetër, ftesat për seancë ka qenë e pa mundur t'i dorëzohen personalisht, sipas konstatimit në fletëkthesë del se i njëjti gjendet në Gjermani, pra i njëjti ka ndërruar adresë, andaj gjykata konform nenit 116 të LPK-së, të paditurit komunikimin me të paditurin për seancat e caktuara e ka bërë përmes tabelës së shpalljeve të gjykatës.

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë të palës së paditur dhe atë konform nenit 423 parag.4 të LPK-së.

Provat e administruara

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: leximi i raportit policor të aksidentit me nr. 2017-GR-0836 i datës 11.10.2017, leximi i konfirmimit të polisës siguroese të datës 22.12.2017, leximi i transferit bankar të datës 25.09.2017 dhe ai i datës 27.02.2018, leximi i ujdive gjyqësore të datave 21.09.2018 dhe 23.02.2018, leximi i ekspertizës së komunikacionit të punuar nga eksperti Ing. A.S. e datës 08.11.2023 dhe dëgjimi i ekspertit Ing. A.S. me datë 27.02.2024.

Gjykata pas vlerësimit të theksimeve të palëve dhe provave të administruara në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit **është tërësisht e bazuar**.

Faktet

Nga leximi i raportit policor të aksidentit me nr. 2017-GR-0836 i datës 11.10.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se deri tek aksidenti ka ardhur si pasojë e veturës "A" i cili e ka goditur automjetin "B" duke e gjuajtur jashtë rruge në anën e djathtë të drejtimit të lëvizjes. Ku për shkak të këtij aksidenti dëme materiale kanë pësuar të dy veturat si dhe lëndime trupore ka pësuar shoferi dhe dy pasagjerët e automjetit "B".

Nga leximi i konfirmimit të polisës siguruese të datës 22.12.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se automjeti i cili kishte shkaktuar aksidentin e datës 11.10.2017 në momentin e shkakimit të këtij aksidenti ka qenë me polisën e sigurimit kufitar, përkatësisht pa mbulesë siguruese, mbulesën e sigurisë e ka pasur valide nga data 11.08.2013 deri me datë 26.08.2013.

Nga leximi i transferit bankar të datës 25.09.2017 dhe ai i datës 27.02.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se është bërë transferimi i shumës prej 1.369.00€ për të dëmtuarit e Familjen Bytyqi dhe 1,155.00€ për të dëmtuarën A.B. në emër të kompensimit të dëmit nga këtu paditësja.

Nga leximi i ujdive gjyqësore të datave 21.09.2018 dhe 23.02.2018, gjykata ka vërtetuar se është arritur marrëveshja jashtëgjyqësore në mes të Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe të dëmtuarve A.B. dhe familjes B. përmes të autorizuarit av. K.M. me të cilën u jdi janë rregulluar të gjitha çështjes që lidheshin me rastin e dëmit të pësuar në aksident trafiku me datë 11.10.2017 në Prizren, ku përgjegjës ishte i padituri – shoferi D.K. ngasës i automjetit “Ssangiong Rexton”. Sipas kësaj marrëveshje në emër të dëmit material të dëmtuarës A.B. i është paguar shuma prej 1,155.00€ kurse familjes B. 1,369.00€.

Nga leximi i ekspertizës së komunikacionit të punuar nga eksperti Ing. A.S. e datës 08.11.2023 dhe dëgjimi i ekspertit Ing. A.S. me datë 27.02.2024 i cili ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë mendimit të dhënë në ekspertizë ku shkaktari i vetëm i këtij aksidenti ka qenë vozitësi i automjetit “Ssangiong Rexton” pa targa të regjistrimit të cilin në momentin kritik e drejtonte i padituri D.K. ku gjatë lëvizjes përgjatë rrugës magjistrale nga Prizreni, në drejtim të Suharekës, duke lëvizur prapa automjetit “Mercedes 204” nuk ka lëvizur me kujdes të shtuar, dhe nuk e ka mbajtur distancë të duhur për shpejtësinë e lëvizjes, kur për pasojë ka shkaktuar aksident komunikacioni.

Baza ligjore

Me nenin 18 par. 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Ligji Nr.04/L-018, dëmspërblimi nga përdorimi i mjetit të pasiguruar është paraparë se: *“Personit të dëmtuar të cilit është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtën të kërkojë dëmspërblimin e dëmit nga byroja”,* me par. 4 të këtij neni është paraparë *“byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”.*

Me dispozitën e nenit 960 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr. 04/L-077 është paraparë që *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”.*

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Nga provat e administruara dhe në bazë të fakteve të kësaj çështje juridike, gjykata ka vërtetuar se me datë 11.01.2017 rreth orës 10:18 min. në Prizren, është shkaktuar aksidenti trafiku dhe se shkaktari i vetëm i këtij aksidenti ka qenë vozitësi i automjetit “Ssangiong Rexton” pa targa të regjistrimit të cilin në momentin kritik e drejtonte i padituri D.K. ku gjatë lëvizjes përgjatë rrugës magjistrale nga Prizreni, në drejtim të Suharekës, duke lëvizur prapa automjetit “Mercedes 204” nuk ka lëvizur me kujdes të shtuar, dhe nuk e ka mbajtur distancë të duhur për shpejtësinë e lëvizjes, kur për pasojë ka shkaktuar aksident komunikacioni. Bazuar në mendimin e ekspertit të komunikacionit të punuar nga eksperti Ing. A.S. të cilës gjykata ia fali besimin e plotë, u vërtetua se deri tek aksidenti kishte ardhur si pasojë e lëshimeve të shoferit të automjetit

SSangzong Rexton, të cilën në momentin e aksidentit e voziste i padituri. Mbi këtë bazë u vërtetua se i padituri kishte qenë shkaktar i aksidentit të komunikacionit të datës 11.10.2017. Në momentin e aksidentit automjeti i të paditurit (si shkaktar i aksidentit) kishte qenë pa mbulesë siguroese, për këtë arsye paditësja e ka kompensuar të dëmtuarën A.B. në shumë prej 1,115.00€ dhe familja B. gjegjësisht S. dhe S.B. 1,369.00€ për dëmin material të shkaktuar nga i padituri e në shumë të përgjithshme 2,524.00€.

Si rrjedhojë, i padituri D.K. si shkaktar i aksidentit, bazuar në ligjin për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, për automjetet e pasiguruara, për dëmin e shkaktuar të dëmtuarve, ka për obligim që të njëjtën shumë t'ia rimburojë këtu paditëses. Andaj, bazuar në këto fakte, Gjykata ka konstatuar se në rastin konkret i padituri duhet të obligohet që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit t'i paguajë shumën prej 2,524.00€. Lartësia e rimbursimit që i padituri detyrohet t'ia paguajë paditëses është e barasvlefshme me shumën që paditësja ia ka kompensuar të dëmtuarës A.B. dhe familja B. në aksident dhe kjo u vërtetua nga transferet bankare bërë nga paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit dhe ujdite jashtëgjyqësore (të cilat gjinden në shkresat e lëndës). Nga dispozitat e lartcekura, e duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, Gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për regresin e dëmit paditëses, pasi që paditësja i'a ka kompensuar të dëmtuarve dëmin e shkaktuar nga ana e të paditurit. Andaj, nga të lartcekurat, u vendos si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv të bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën për dëmin material nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (18.06.2020), për shkak se paditësja i'a ka kompensuar dëmin të dëmtuarve, ndërsa këtu i padituri si përgjegjës për dëmin e shkaktuar nuk i ka kompensuar të njëjtat dëme paditëses.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale sipas pikës nën III të këtij aktgjykimi, është marrë konform nenit 449 dhe 452 par.1 lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, ashtu që e detyroi të paditurin që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet procedurale në emër të taksës gjyqësore shumën prej 40.00€ dhe në emër të ekspertizës shumën prej 150.00€, e në shumë të përgjithshme në lartësi prej 190.00€.

Nga faktet dhe arsyet e cekura më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.198/2020 më datë 27.02.2024

B. Profesionale
Delvina Ajazaj

Gjyqtarja
Njomëza Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.